

Shërbime përkthyesish

Shërbime përkthyesish në "Michigan Medicine"

Përkthyes të trajnuar dhe të certifikuar ndihmojnë pacientë ose pjesëtarë të familjes së tyre, të cilët mund të kenë aftësi të kufizuara në anglisht (limited English proficiency (LEP)) ose ata të cilët nuk dëgjojnë, që nuk dëgjojnë/shikojnë apo që kanë vështirësi në dëgjim. Këta përkthyes ndihmojnë njerëzit të komunikojnë me personelin dhe ofruesit tanë të kujdesit, për të siguruar akses të barabartë në një kujdes shëndetësor cilësor.

Përkthyesit tanë mjekësorë ndihmojnë ofruesit e kujdesit të ofrojnë kujdes kompetent kulturor – gjë e cila është thelbësore për t'u siguruar që secili prej pacientëve tanë të marrë kujdes shëndetësor të cilësisë së lartë.

Për të marrë informacion mbi burimet tona në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, klikoni në gjuhën sipas zgjedhjes suaj më poshtë.

Përkthyesit janë të disponueshëm 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Ata ofrojnë shërbime përkthimi në më shumë se 40 gjuhë dhe shërbim për pacientët që nuk dëgjojnë, që nuk dëgjojnë/shikojnë ose që kanë vështirësi në dëgjim apo që kanë aftësi të kufizuara në anglisht (LEP).

Klikoni këtu për të kontaktuar me Shërbime përkthyesish